

UJI I KOSOVËS
#ujepërkosovën
№7



BULETIN

SISTEMET E INFORMACIONIT TË UJIT

NJË KOMPONENTË THELBËSORE PËR MENAXHIM MË TË MIRË TË UJIT



Integrated Water Resources
Management in Kosovo



Arnulf Schönbauer

EDITORIAL

Në menaxhimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të resurseve ujore, informacioni i besueshëm dhe i përditësuar është një bazë e domosdoshme për vendime të bazuara në njohuri. Sasia e këtij informacioni është e madhe dhe nevojiten sisteme të fuqishme informacioni për ujin (Water Information Systems - WIS) për të menaxhuar dhe përdorur të dhënat.

WIS nuk janë produkte të gatshme, por produkte me porosi që janë ndërtuar sipas kërkesave të përcaktuara saktësisht.

Në përgjithësi, janë ekspertët e ujit në administratën publike ata që nisin procesin e zhvillimit dhe vendosin kërkesat. Meqenëse WIS do të përdoret gjithashtu nga grupe të tjera përdoruesish, si shkencëtarët dhe publiku, nevojat e tyre duhet të merren parasysh. Konceptet e të drejtave të përdoruesit për WIS duhet të shkruhen për të përcaktuar se cilat të dhëna lejohet t'i ngarkojë, shikojë dhe shkarkojë një grup përdoruesish. Në këtë kontekst, siguria e të dhënave dhe mbrojtja e të dhënave personale luajnë një rol të rëndësishëm.

WIS synon të lehtësojë punën e ekspertëve me të dhënat. Për shembull, mund të sigurohen funksione për ngarkimin e të dhënave në databazën që kontrollon formatin e të dhënave (nëse ai përputhet me specifikimet) dhe nëse vlerat janë të besueshme. Kjo e lehtëson punën e ekspertëve sepse në të kundërtën do të duhej ta kryenin manualisht jashtë WIS. Përveç kësaj, WIS kontribuon në sigurimin e cilësisë pasi sistemi elektronik parasheh më pak gabime sesa njerëzit.

Avantazhi kryesor i WIS-it qëndron në mundësinë e përpunimit të shpejtë dhe vlerësimit të sasive të mëdha të të dhënave për të kryer llogaritjet dhe për të vizualizuar rezultatet.

Vizualizimi i të dhënave dhe rezultateve me anë të diagrameve, hartave elektronike dhe tabelave i ndihmon ekspertët e ujit, për shembull, në njohjen e trendeve ose përcaktimin e problemeve. Megjithatë, vizualizimi gjithashtu u lejon njerëzve me pak njohuri teknike që të kuptojnë më mirë sfidat dhe çështjet në menaxhimin e resurseve ujore dhe kështu të marrin pjesë në procesin e palëve të interesit.

Siç u përmend, WIS-i iniciohet nga ekspertë të ujit, por programohet nga ekspertë të IT-së. Kjo kërkon një mirëkuptim të përbashkët midis ekspertëve të ujit dhe ekspertëve të IT-së në lidhje me kërkesat dhe prioritetet. Kjo është sfiduese, pasi të dyja palët flasin gjuhët e tyre teknike dhe kanë ide të ndryshme për proceset e punës. Sidomos në fillim të zhvillimit të WIS-it janë të nevojshme proceset intensive dhe të rregullta të koordinimit midis ekspertëve të ujit dhe ekspertëve të IT-së.

Me WIS, grupet e të dhënave të mbajtura nga institucione të ndryshme në baza të ndryshme të dhënash, si regjistri i tokës, IHM ose Agjencia e Mjedisit, mund të bashkohen. Kjo do të thotë se çështjet teknike të avancuara duhet të zgjidhen dhe se ekspertë të ndryshëm duhet të përfshihen në procesin e zhvillimit.

Një WIS mund të ofrojë një sërë veçorish teknike. Fatkeqësisht, kostoja e zhvillimit dhe funksionimit është kufizimi kryesor i fushëveprimit të funksioneve. Prandaj, lista e dëshirave për një WIS duhet të vlerësohet mirë dhe të ketë përparësi.

Si përfundim, në ngritjen dhe funksionimin e WIS-it, administratat e ujit përballen me sfida të mëdha teknike, koordinuese dhe financiare, për të cilat Programi IWRM-Kosovë ofron udhëzime se si të tejkalohen ato. Një përzgjedhje e aktiviteteve të IWRM-K në fushën e WIS mund të lexohet në këtë buletin.

Z. Arnulf Schönbauer është Koordinator i Programit IWRM-K dhe punon në ekipin e ujërave nëntokësore të Umweltbundesamt (EAA – Agjencioni Austriak i Mjedisit). EAA është partneri në Programin IWRM-K dhe zhvillon dhe operon bazat e të dhënave si pjesë e punës së tij. Ato mbulojnë aspekte të ndryshme mjedisore, si cilësia e ujit, cilësia e ajrit, menaxhimi i mbetjeve dhe shumë më tepër.

Menaxhimi efikas dhe i përforcuar i ujit supozon qeverisje më të mirë, shpërndarje më të shpejtë dhe përfshirje më të madhe të përdoruesve dhe publikut në punën e këtij sektori. Teknologjia e informacionit lejon përafrimin më të mirë të produkteve të informacionit me nevojat e përdoruesve dhe shpërndarjen tek të gjithë ata që kanë nevojë për atë informacion. Konceptet dhe mjetet e reja, si intelijenca artificiale, të dhënat e hapura për të mirën publike, GIS dhe qeverisja elektronike, e kanë rritur efikasitetin dhe cilësinë në krijimin dhe shpërndarjen e të mirave publike.

Ndëveprimi në mes administratave qeveritare dhe institucioneve publike është një mundësi kyçe për ofrimin më efikas dhe efektiv të shërbimeve dixhitale. Shkëmbimi dhe përdorimi i të dhënave dhe përvojave/zgjidhjeve më të mira mund të zvogëlojë ndjeshëm rritjen e kostove. Pa një sistem informacioni, edhe performanca më e shkëlqyer e çdo sektor publik ose privat mund të kalojë pa u vënë re në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, sepse përdoruesit e sektorit, palët e interesit, entet publike dhe private dhe qytetarët, kanë mundësi të kufizuara për të hyrë, për t'u informuar dhe përfshirë në qendra të gjera, të ndërveprueshme dhe të integruara të shkëmbimit të informacionit.

SISTEMI INFORMATIV I UJIT (WIS) TË KOSOVËS



Visnja Omerbegoviq
Eksperte e WIS

Të dhënat dhe informacionet, së bashku me teknologjinë informative dhe ata që e menaxhojnë atë, janë asete publike kritike të Kosovës. Nevojat dhe sfidat për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin sistematik të të dhënave janë rritur për shkak të përkushtimit të Kosovës ndaj politikës së BE-së për ujin dhe acquis. Sektori i ujit në Kosovë ka një përgjegjësi të rëndësishme administrimi mbi krijimin dhe menaxhimin e një sistemi efektiv informativ që mbështet arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjike të menaxhimit të integruar të resurseve ujore.

Sistemi Informativ i Ujit të Kosovës (WIS-K) duhet të përmbushë nevojat dhe pritshmëritë e të gjithë përdoruesve të ujit, dhe një grupi të gjerë të palëve të interesit dhe publikut. Zhvillimi i mëtejshëm i WIS-K synon të mbështesë një sërë aktiviteteve aktuale dhe ato të ardhshme të sektorit të ujit dhe angazhimeve të raportimit në nivel kombëtar, rajonal dhe të BE-së. Disponueshmëria, qëndrueshmëria, saktësia, cilësia dhe integriteti i të dhënave nga burime të ndryshme, si dhe teknologjia e informacionit dhe kapacitetet për të menaxhuar dhe mirëmbajtur sistemin, janë kritike për qëndrueshmërinë e WIS-K. Sfidat shtohen nga fakti se përveç mundësisë të qasjes së kontrolluar në arkivimin dhe ndarjen e të dhënave dhe informacioneve të lidhura me ujin, WIS duhet të sigurojë gjithashtu zbatimin e politikave, protokolleve dhe procedurave për sigurimin e cilësisë, mirëmbajtjen dhe raportimin e metadata.

WIS-K duhet të lehtësojë dhe promovojë qasjen - dhe shpërndarjen - e të dhënave dhe informacioneve të lidhura me ujin, si aktuale ashtu edhe historike, në kohë reale dhe në mënyrë të sigurt. Përdorimi i WIS-K duhet të jetë një çështje rutinë në mbështetjen e aktiviteteve ditore dhe proceseve të vendimmarrjes, përgatitjen dhe zbatimin e Planeve të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore dhe Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmblytjet, planifikimin dhe menaxhimin e programeve dhe projekteve të investimeve, si dhe Monitorim dhe Vlerësim, dhe për Raportim. Duke pasur parasysh lidhjen komplekse midis monitorimit të gjendjes së ujit dhe parashikimit, vlen të theksohet se sistemet e monitorimit të ujit janë burimi kryesor i të dhënave sasiore dhe cilësore dhe është thelbësor për pothuajse të gjitha aktivitetet e menaxhimit të ujit.

WIS-K duhet t'i përgjigjet sfidave dhe të ofrojë mbështetje për të kënaqur nevojat e profesioneve dhe ekspertëve të ndryshëm, duke gjeneruar gjithashtu përfitime gjatë ndërtimit të kapaciteteve dhe inovacionit të udhëhequr nga zhvillimet e përshpejtuara dhe të pandalshme në teknologjinë e informacionit.



Behare Bajraktari
Gazetare dhe publiciste

Në Samitin Botëror të Ujit në Berlin, u diskutuan disa çështje për ujin, si rritja e çmimeve, teknologjia, ndotja, sistemet e ujit dhe ndryshimet klimatike.

Cilësia e ujit ishte një nga temat shqetësuese në këtë Samit, duke përfshirë ndotjen nga klorothalonili, një fungicid i përdorur për 30 vjet në disa vende evropiane dhe kimikate të tjera të rrezikshme. Sipas raportit të Kadastrit të Ndotësve të Ujërave të Kosovës, të gjithë ndotësit janë të pranishëm në ujin tonë.

Teknologjitë e reja për të filtruar metabolitët mund të rrisin çmimin e ujit deri në 75%, ka raportuar shtypi zviceran. Gazeta franceze Le Monde gjithashtu vë në pah faktin se prodhuesit e ujit mund të përballen me një faturë pastrimi që kushton miliarda euro, e cila në mënyrë të pashmangshme do t'u kalonte konsumatorëve.

Samiti Botëror i Ujit në Berlin:

Uji është manifestimi i krizës klimatike.

Teknologjia dhe inovacioni si zgjidhje për problemin e ujit

Në Samit u tha se uji nuk njihet kufij, prandaj duhet të miratojmë zgjidhje të reja dhe teknologji të reja për cilësinë dhe menaxhimin e ujit. U prezantuan teknologji të reja për ujin industrial apo ujin në shishe si dhe teknologji të ujit që mund të përshpejtojnë procesin dhe të maksimizojnë efikasitetin. Inovacioni u pa si shpëtimtari nga ndryshimet klimatike dhe rrjedhimisht të burimeve ujore. Por, sipërmarrësit e kompanive më të mëdha botërore thanë se uji nuk mund të pihet më ose të shitet në të njëjtën mënyrë. Komercialistët në këtë Samit thanë: "Kur çmimi rritet, rritet edhe vlera".

Partneriteti publiko-privat është çelësi i zgjidhjes

Një nga pikat kryesore të diskutuara ishte ulja e emetimeve deri në vitin 2030, e cila kërkon një plan, një afat dhe një model zbatimi për të reduktuar emetimet e gazeve serrë. Gjithashtu u theksua se çdo vend duhet të ketë një strategji të detajuar të ujit që mbulon periudhën deri në vitin 2030. Uji është mbijetesa jonë dhe ne nuk duhet të luajmë me të. Një thirrje e shpeshtë e bërë në këtë samit ishte krijimi i partneriteteve për të shmangur konfliktet për shkak të ujit të pijshëm, veçanërisht në vendet që kanë mungesë uji. Samiti pranoi se "Uji është manifestimi i gjithë krizës klimatike". Kriza e ujit dhe ndryshimet klimatike janë kriza të ndara dhe mendësia duhet të ndryshojë, pasi uji nuk është emetuesi i emisioneve serrë siç është energjia dhe transporti, dhe nga perspektiva e ujit është krejtësisht diçka tjetër. Uji është pika qendrore se si ndryshimet klimatike ndikojnë thellësisht në jetën e njerëzve.

SAMITI I BERLINIT ADRESOI 4 SFIDA:

Sasia e ujit, Ruajtja e Energjisë, Çmimi dhe Cilësia e Ujit, Dialogu për Ujin



Moti ekstrem do të bëhet edhe më i pranishëm për shkak të ndryshimeve klimatike. Ndërkohë, janë të shumta kompanitë që po shpërdorojnë burimet ujore, si lumenjtë. Në procesin e ujit, kompanitë duhet të shmangin humbjet e ujit duke përdorur teknologji të reja.

Në dialogun për ujin dhe dekarbonizimin duhet të ketë investime, risi dhe bisedime me njerëzit dhe komunitetet. Pyetjet e bëra ishin, çfarë uji prodhohet ndërkohë që komunitetet po rriten, a duhet të shitet uji industrial nga burime të cilësisë së ulët dhe si duhet të riciklohet uji?

Menaxhimi i ujit dhe infrastruktura ujore në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike është një sfidë dhe ka nevojë për adresim urgjent, pasi uji i pijshëm po konsumohet tepër dhe së shpejti mund të mos jemi në gjendje të ruajmë të njëjtin bilanc ujorë.



Vizitë Studimore lidhur me Sistemin Informativ të Ujit:

Përmirësimi i Menaxhimit të Resurseve Ujore nëpërmjet Integritimit të të Dhënave

Programi IWRM-K organizoi, në bashkëpunim me partnerët nikoqir në Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe institucionet e lidhura me ujin në Kroaci, një vizitë studimore për stafin partner nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Grupit të Profesionistëve të Rinj të Ujit në Kosovë. Fokusi i vizitës ishte në sistemet e informacionit të ujit, me synim eksplorimin e strategjive efektive për përmirësimin e menaxhimit të resurseve ujore përmes integritimit të të dhënave.


Vizita studimore, përveç përfitimeve të tjera, ofroi një platformë të shkëlqyer për rrjetëzimin dhe bashkëpunimet e ardhshme me kolegët në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kroaci.

Në përgjithësi, përmes kësaj vizite studimore unike, pjesëmarrësit fituan njohuri të vlefshme, shkëmbyen përvoja dhe hulumtuan qasje inovative për menaxhimin e resurseve ujore përmes sistemeve efektive të informacionit për ujin.

Gjatë vizitës studimore, pjesëmarrësit:

(i) eksploruan teknologjitë inovative: ata u njohën me teknologjitë dhe sistemet më të fundit për mbledhjen, analizën dhe menaxhimin e të dhënave, duke përfshirë sensorin në distancë, sistemet e informacionit gjeografik (GIS) dhe mjetet e avancuara të vizualizimit të të dhënave; dhe

(ii) shkëmbyen praktikat më të mira: u angazhuan në sesione të shkëmbimit të njohurive me ekspertë, profesionistë të menaxhimit të ujit dhe përfaqësues nga organizatat kryesore të përfshira në menaxhimin e resurseve ujore. Pjesëmarrësit patën mundësinë të diskutojnë sfidat, të ndajnë përvojat dhe të mësojnë nga studimet e suksesshme të rasteve të të dy vendeve nikoqire.



Delegacioni i Kosovës u angazhua në diskutime mbi kornizat e politikave, strukturat qeverisëse dhe aranzhimet institucionale të nevojshme për menaxhimin efektiv të të dhënave të resurseve ujore dhe informacionit. Këto diskutime kontribuojnë në eksplorimin e strategjive për Kosovën për të integruar sistemet e informacionit të ujit në proceset më të gjera të vendimmarrjes në nivel lokal dhe kombëtar.



Në një përpjekje të përbashkët për të parandaluar ndotjen e ujit që rrjedh nga aktivitetet bujqësore, Programi IWRM-K po mbështet aktivitetet për të prezantuar praktikat miqësore me mjedisin në menaxhimin e plehut organik. Gjatë tre ditëve intensive të trajnimit, 40 fermerët u fuqizuan me njohuri dhe ekspertizë të paçmueshme. Ata përfituan nga njohuritë e reja të praktikave të mira bujqësore, përmirësuan aftësitë e tyre në menaxhimin e plehut organik dhe eksploruan marrëdhëniet midis racioneve të ushqimit dhe përbërjes së plehut organik. Për më tepër, fermerët fituan njohuri mbi avantazhet ekonomike të adoptimit të praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të plehut organik dhe u njohën me lloje të ndryshme të objekteve të ruajtjes së plehut organik. Me këtë njohuri të re, këta fermerë tani janë gatë të promovojnë metoda bujqësore të përgjegjshme, duke mbrojtur resurset tona të vlefshme ujore dhe duke punuar drejt një të ardhmeje të begatë dhe miqësore me mjedisin.

Padyshim, sukses i madh është arritur me akreditimin e programit më të avancuar Master Shkencor në Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore (MSc-IWRM) që do të zbatohet nga partneriteti akademik në mes të Universitetit të Prishtinës 'Hasan Prishtina' dhe Universiteti 'Haxhi Zeka', Pejë, mbështetur nga IWRM-K. I krijuar për të pajisur studentët ambiciozë me njohuritë, aftësitë dhe mjetet për t'u bërë lider në sektorin e ujit, ky program gjithëpërfshirës, multidisiplinar hap dyert për mundësi emocionuese.

MP-IWRM është një program rigoroz dhe dinamik që plotëson nevojat e profesionistëve aspirantë që kërkojnë të shkëlqejnë në karrierën e tyre. Ai ofron pista të specializuara në disiplina të ndryshme, duke përfshirë inxhinierinë, ekonominë dhe aspektet ligjore të menaxhimit të ujit, duke i lejuar studentët të përshtatin arsimin e tyre me interesat dhe ambiciet e tyre unike.

IWRM-K PROGRAM NEWS

Programi IWRM-K dhe Instituti Kosovar për Administratë Publike (IKAP) kanë kënaqësinë të njoftojnë përfundimin me sukses të ciklit të parë të Programit gjithëpërfshirës të trajnimit për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore (TP-IWRM). Ky moment kthese shënon një hap të rëndësishëm në fuqizimin e profesionistëve të ujit për të trajtuar kompleksitetin e menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve ujore dhe për të siguruar një të ardhme të sigurt nga uji.

Aktivitete intensive dhe të ndryshme janë duke u zbatuar nga OJQ-të në kuadër të Skemës së Granteve për OSHC-të. Planet e ndryshme komunale/lokale si plani i veprimit në mjedis, rregulloret për resurset ujore, mbështetja në zbatimin e ligjeve për ujërat, ngritja e kapaciteteve për zyrtarët komunalë etj., janë pjesë e projekteve, bashkëpunimit dhe ndërveprimit me shumë komuna të pellgut të Ibrit, Lepencit dhe Moravës së Binçës. Gjithashtu, shumë OJQ kanë aktivitete edukative/trajnuese me të rinjtë dhe shkollat, aktivitete sensibilizuese, avancimin e rolit të gruas, si dhe aktivitete vullnetare. Disa OJQ janë duke zbatuar projekte në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës së resurseve ujore në nivel lokal.

Në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin e Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL), Programi IWRM-K ka krijuar Mekanizmin Shumë Palësh për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore. Ky mekanizëm përbëhet nga 18 anëtarë nga të gjithë akterët e sektorit të ujit dhe është rezultat i shumë seminareve, takimeve dhe konsultimeve që janë mbajtur ndërmjet Programit, ARPL-së dhe palëve të interesit. ARPL dhe Programi IWRM-K synojnë të aplikojnë dhe promovojnë qasje gjithëpërfshirëse gjatë hartimit të planeve për menaxhimin e pellgjeve lumore duke përfshirë përfaqësues të institucioneve të ndryshme, ekspertë të sektorit dhe akterë nga fushat që janë të përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në sektorin e ujit, për të diskutuar hapur problemet, situatën me resurse ujore, idetë dhe opsionet për marrjen e masave dhe për zgjidhjet më të mira.

Programi IWRM-K dhe Instituti Kosovar për Administratë Publike (IKAP) kanë kënaqësinë të njoftojnë përfundimin me sukses të ciklit të parë të Programit gjithëpërfshirës të trajnimit për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore (TP-IWRM). Ky moment kthese shënon një hap të rëndësishëm në fuqizimin e profesionistëve të ujit për të trajtuar kompleksitetin e menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve ujore dhe për të siguruar një të ardhme të sigurt nga uji.



Nerodime Bifurkacioni

Pasuri unike e trashëgimisë natyrore

Lumi Nerodime rrjedh nga bjeshkët e Jezercit dhe njihet si një rezervat i veçantë natyror sepse ndahet në dy degë që nuk takohen më me njëra tjetrën. Dega veriore e lumit Nerodime derdhet në lumin Sitnicë, i cili përmes rrjedhës së lumit lber përfundon në Detin e Zi. Ndërsa dega jugore, përmes lumit Lepenc dhe më pas Vardarit, derdhet në detin Egje. Ky fenomen e bën Bifurkacionin e Nerodimes unik në Evropë, prandaj edhe lokacioni, ku ndodhë kjo ndarje, ka statusin e Monumentit Natyrorë me Rëndësi të Veçantë IUCN/III. Në zonën e Bifurkacionit të Nerodimes, ndodhet edhe një mulli qindra vjeçar si pjesë e kësaj pasurie unike të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Sipas përfaqësuesit të OJQ "Gjethi", z. Valon Raka, ky mulli ka më shumë funksion të trashëgimisë kulturore, një lloj muzeu lokal, i cili mirëmbahet shumë mirë dhe përdoret për të promovuar turizmin lokal dhe rajonal, si shembull i stilit të jetesës në të kaluarën. Ai më tej shton se përveç OSHC-ve që punojnë për mbrojtjen e këtij lokacioni, Komuna e Ferizajt ka realizuar një projekt të financuar nga Zyra e BE-së në Kosovë me titull "Zhvillimi i Turizmit në Regionin Lindor të Kosovës". Bifurkacioni i Nerodimes është i pajisur me tabela, është i mirëmbajtur dhe është në gjendje të mirë fizike. Edhe pse për lidhjen e gurëve është përdorur llaç çimentoje, shtrati është i shtruar me gurë natyralë dhe vegjetacioni ruhet rregullisht.

Sipas banorëve të zonës, problemi që e karakterizon këtë monument natyror është thatësira pasi gjatë stinës së verës uji shterron në të dy degët. Ndërsa, analiza SWOT e aseteve të trashëgimisë natyrore tek "Plani Zhvillimor Komunal 2017-2025 i Komunës së Ferizajt" e sheh si dobësi keqpërdorimin e ujit, ndërsa si kërcënim e konsideron tharjen e shtratit të lumit nga tejshfrytëzimi i ujit të lumit Nerodime.*



Kjo analizë, nga njëra anë, pasqyron gjendjen aktuale të Bifurkacionit ku uji në fakt rrjedh vetëm në degën që derdhet në detin Egje, ndërsa ai që derdhet në Detin e Zi duket se ka shumë pak ose aspak rrjedhje uji. Nga ana tjetër, ngërthehet me shqetësimin e ngritur nga OJQ Gjethi: "Edhe pse unik në Evropë, Bifurkacioni në Ferizaj fatkeqësisht është komercializuar dhe duket se ka humbur funksionin unik që kishte. Njëra degë nga të dyja duket se nuk ka fare rrjedhje të ujit. Ekspertët e mjedisit dhe të ujit, por edhe qytetarët duhet të bëjnë maksimumin që Bifurkacioni i Nerodimes të kthehet në gjendjen e tij natyrore".

Ndërsa, në nivel global, është lumi Casiquiare (i cili buron në Venezuelë) që lidh dy nga lumenjtë më të mëdhenj në botë, lumenjtë Orinoco dhe Amazon. Këta dy lumenj të cilët i furnizon i njëjti burim kanë dy grykëderdhje detare të ndryshme.




*<https://kk.rks-gov.net/ferizaj/wp-content/uploads/sites/31/2018/04/3333.pdf>


#POSTIMETNËRRJETETSOCIALE

 **United Nations** |  **UN WATER**


Take #WaterAction and become a food hero!
This year, the #WorldFoodDay campaign highlights the importance of water. "Water is life, Water is food. Leave no one behind" shines light on how water is crucial for life on Earth and is the foundation of our food.



<https://buff.ly/3Q49404>

 **WORLD METEOROLOGICAL ORGANIZATION**

Copernicus confirms July 2023 was the hottest month ever recorded



<https://bit.ly/47ksxal>

 **WORLD ECONOMIC FORUM**


Is water tech the next frontier for investment?



https://www.weforum.org/agenda/2023/07/water-tech-investment?utm_source=facebook&utm_medium=social_scheduler&utm_term=Water&utm_content=22%2F07%2

Ky **BULETIN**

Mbështetet nga programi IWRM-K i SDC-së i bashkëfinancuar nga Qeveria e Kosovës dhe zbatuar nga Skat Consulting Ltd., St. Gallen, Zvicër dhe Agjencia Austriake e Mjedisit (EAA).

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

skat Swiss Resource Centre and
Consultancies for Development



Integrated Water Resources
Management in Kosovo



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ENVIRONMENT AGENCY AUSTRIA **umweltbundesamt**

Na ndiqni

Facebook: iwrn_k Instagram: iwrn_k
linkedin: iwrn_k twitter: iwrn_k

www.iwrn-k.com

Na kontaktoni

Skat Consulting Ltd.
Integrated Water Resources
Management in Kosovo
136 Pashko Vasa Street
Floor I. No.5, Pejton
Pristina, Kosovo
Email: kosovo@skat.ch